



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

**VENDIM**  
**Nr. 314, datë 14.09.2020**

**PËR**  
**FILLIMIN E PROCEDURËS SË PËRSHPEJTUAR TË DETYRUAR TË VLERËSIMIT**  
**ETIK DHE PROFESIONAL, VITI KALENDARIK 2019, PËR GJYQTARËT QË KANË**  
**PLOTËSUAR KRITERET LIGJORE TË KANDIDIMIT PËR NGRITJE NË DETYRË**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronja “a” dhe “ë” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 85 e vijues të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin 61, pika 1, nenin 63 dhe nenin 86, shkronja “dh”, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263 datë 22.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.70 datë 07.02.2020 “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, pas verifikimit të kriterëve të kandidimit për gjyqtarët që kanë aplikuar për ngritje në detyrë në Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe Gjykatat e Apelit, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale dhe mbas shortit të realizuar,

**VENDOSI:**

- I. Fillimin e procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional viti kalendarik 2019, për gjyqtarët që kanë plotësuar kriteret ligjore të kandidimit për ngritje në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe Gjykatat e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.
- II. Caktimin e relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin për secilin gjyqtar, si më poshtë:
  1. Për gjyqtaren znj. {...}– Relatore znj. Brikena Ukperaj - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin z. Fatbardh Çoniku.
  2. Për gjyqtaren znj. {...} - Relator z. Erjon Muharremaj - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin z. Fatbardh Çoniku.
  3. Për gjyqtaren znj. {...}– Relatore znj. Brunilda Kadi - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha.
  4. Për gjyqtaren znj. {...}- Relator z. Erjon Muharremaj - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha.
  5. Për gjyqtaren znj. {...}- Relatore znj. Brikena Ukperaj - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha.
  6. Për gjyqtaren znj. {...}– Relator z. Erjon Muharremaj - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili.

7. Për gjyqtaren znj. {...}– Relatore znj. Brunilda Kadi - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili.
8. Për gjyqtaren z. {...}– Relatore znj. Brikena Ukperaj - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili.
9. Për gjyqtaren z. {...}– Relatore znj. Brunilda Kadi - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin z. Fatbardh Çoniku.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

## **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**